



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-047

Prishtinë, më 30 nëntor 2015, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 NËNTOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit se në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 23 nëntor 2015, është vendosur që seanca plenare të mbahet sot, më 30 nëntor 2015, në orën 11:00, si dhe është caktuar paraprakisht që në orën 9:00 të mbahet mbledhja e Kryesisë për t'i paraqitur qëndrimet e opozitës nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, lidhur me bllokadën që opozita po ia bën Kuvendit.

Kryetari më pas ia dha fjalën nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, deklaroi se mbrëmë liderët e opozitës e kanë pasur një takim, mirëpo ende nuk e kanë një vendim lidhur me seancën e sotme për qëndrimin që Kryesia e Kuvendit nëpërmjet saj ka kërkuar t'ua përcjellë liderëve të opozitës.

Ajo tha se është vetëm përfaqësuese brenda Kryesisë, por nuk është personi që merr vendime në këtë rast, ndërsa takimin e radhës liderët e opozitës (VV, AAK dhe "Nisma") e kanë në orën 9:30, nga i cili pritet se çfarë qëndrimi do të mbajnë lidhur me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit për seancën plenare, e cila është caktuar për sot.

Në fund, kryetari konstatoi që seanca e caktuar për sot, më 30 nëntor 2015, në orën 11:00, do të mbahet sipas agjendës së caktuar në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 23 nëntor 2015.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 9:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale